

Bashkimi Sovjetik para luftës së dytë botërore

Elena Marushiakova / Veselin Popov

Normat Shtetërore dhe Politike | “Unioni Gjithë-rusë i Ciganëve” | “Kolkozet Cigane” (kooperativat) | Punëtoritë zejtare të kooperativës Cigane | Gjuha dhe Literatura Rome | Arsimi | “Teatri Romen” | Shtypjet e viteve të 1930-ta | Një kthesë në politikën nacionale

➤ *Krijimi i Bashkimit Sovjetik shpesh është quajtur “një eksperiment i madh historik” që përcaktoi fatin e një pjese të konsiderueshme të botës dhe shumë njerëzve. Politikat ndaj romëve në Bashkimin Sovjetik iu takojnë dy periudhave qartësisht të ndara, bazuar në dy parime rrënjësisht të ndryshme: Nga krijimi i Bashkimit Sovjetik deri në vitin 1938 parimi udhëheqës ishte trajtimi i romëve si popull i ndarë, të cilët duhet të zhvillohen si një element përbërës i shoqërisë sovjetike; pas vitit 1938 modeli ndryshoi, qasja “speciale” që mundësonte një “qasje mbizotëruese” dhe romët mbi të gjitha konsideroheshin një pjesë integrale e shoqërisë sovjetike.*

BASHKIMI SOVJETIK 1922 - 1940 III.1

Data kur Republikat u bënë pjesë e BRSS-së:

1922 1924 1929 1936 1940



PARATHËNIE

Revolucioni Socialist i Madh i Tetorit i vitit 1917 dhe lufta pasuese civile rezultuan në ndryshime rrënjësore socio-politike. Një lloj i ri dhe rrënjësisht i ndryshëm i shtetit, Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike (BRSS), u themelua në vend të Perandorisë Ruse, me marrëdhënie të reja ekonomike, struktura sociale, standarde politike

dhe kulturore. Nën këto kushte romët iu nënshtruan një politike shtetërore dhe gradualisht tentuan të gjejnë vendin e tyre sipas kushteve të reja dhe t'i adaptohen realitetit të ri.

Lufta Civile, intervenimi i huaj, kaosi në jetën sociale, kolapsi i përgjithshëm i ekonomisë dhe varfëria e shpejtë e popullsisë rezultuan në një përqendrim të situatës së romëve. Shumica e tyre vazhduan mënyrën e tyre tradi-

cionale (gjysmë-) nomade të jetesës, një pjesë tjetër, që tanimë ishin vendosur në qytete, iu kthyen profesioneve shëtitëse. Një pjesë e vogël e “elitës muzikore” rome arriti të emigronte së bashku me rusët e “bardhë”. Numri i përgjithshëm i romëve sipas regjistrimit të vitit 1926 ishte 61,299. Ishte një numër relativisht i vogël, 20.9%, që jetonin në qytete, ndërsa më shumë se 2/3 vazhduan mënyrën e tyre udhëtuese të jetesës.

ZGJIMI I “BUKUROSHES SË FJETUR” –
“UNIONI GJITHË-RUS I CIGANËVE”

“Unioni Gjithë-Rus i Ciganëve” formuloi qëllimet e tij në pajtim me shpirtin e ideologjisë dominuese – për bashkimin e romëve, tërheqjen e tyre drejt “punës shoqërisht të dobishme”, ndihmën në krijimin e kooperativave dhe bashkësive, organizimin e romëve shëtitës në kalimin e tyre drejt një mënyre të vendosur të jetesës, krijimin e mësimit të mbrëmjes dhe shkollave të së dielës, klubeve dhe bibliotekave, publikimin e gazetave, librave, teksteve mësimore dhe broshurave në gjuhën Romani, luftimin e dehjes, lypjes së lëmshës, dhe fallit.

“Unioni Gjithë-Rus i Ciganëve” dërgoi Aleksander Grakhovskii si përfaqësues të tij në Bjellorusi në vitin 1926. Me 29 shtator, 1926, në Minsk u mbajt një mbledhje nga një grup i aktivistëve romë, në të cilën njëri nga të pranishmit, G. Toura deklaroi se “kombi Cigan, sikurse bukuroshja e fjetur, është zgjuar nga një gjumë i thellë nga magjistarja e revolucionit”. Një vendim u morë për statutet e “Unionit të ardhshëm të Ciganëve” në Republikën Socialiste Sovjetike të Bjellorusisë, i vërtetuar nga Komisariati Bjellorus i Punëve të Brendshme të

Republikës Socialiste Sovjetike të Bjellorusisë, puna përgatitore filloi për themelimin e unionit të ri. Mirëpo, pas shpërbërjes së “Unionit Gjithë-Rus” çështja nuk ishte më tematike.

“Unioni Gjithë-Rus i Ciganëve” ekzistoi për një kohë relativisht të shkurtë dhe u shpërbë me anë të dekretit të NKVD-së me 15 shkurt, 1928. Arsye të ndryshme u dhanë për atë vendim – “mungesa e shtresës proletare në nivel menaxherial” (nga 23 anëtarë në menaxhment, 9 në të kaluarën kishin qenë tregtarë kuajsh), aktivitetet e dobëta organizative (unioni kishte dështuar të hap sektorët në atë vend), rezultatet e pamjaftueshme në punën drejt shtyrjes së romëve udhëues të vendosen, konfliktet e brendshme, menaxhmenti i dobët financiar (15,000 rubla mungonin nga bilanci i gjendjes) etj.

III. 2

“LUMTURIA E RE” NË “RRUGËN E KUQE” –
“KOLKOZET CIGANE”

“Kolkozet Cigane” u krijuan në mënyra të ndryshme. Shumë nga përfaqësuesit romë drejtpërdrejtë iu drejtuan Komitetit Qendror Ekzekutiv Gjithë-Rus me një kërkesë për ndihmë lidhur me vendosjen e tyre, mirëpo, shumë shpesh ata ose nuk e merrnin seriozisht financimin dhe do të zhdukeshin, ose do të shkonin në vendet ku ishin dërguar

NORMAT SHETËRORE
DHE POLITIKE

Pushteti sovjet tanimë kontrollonte tërë territorin e BRSS-së në fillim të viteve të 1920-ta, dhe një stabilizim gradual ekonomik dhe social filloi të vendosej. Autoritetet në masë të madhe filluan të merren me çështjet nacionale dhe etnike në këtë vend shumë të madh, ku shumë popuj të ndryshëm jetonin (në mes të 150 dhe 200 popujve sipas kriterëve të ndryshme). Në të njëjtën kohë një numri të konsiderueshëm të popujve nuk iu ishte dhënë e drejta për themelimin e shtetit të tyre dhe institucioneve administrative, por vetëm strukturave socio-politike dhe kulturore. Romët ishin në mesin e tyre, dhe për ta mungesa e një institucioni të tillë ndoshta ishte më e arsyeshmja për shkak të numrit relativisht të vogël të tyre, mënyrës kryesisht nomade të jetesës, shtrirjes së territoreve të zëna, dhe mbi të gjitha mungesës së një elite që do të kërkonte institucione shtetërore dhe administrative.

Përgjatë tërë ekzistencës së BRSS-së dhe në legjislacionin e saj romët në asnjë mënyrë nuk ishin ndarë nga dhjetëra

popuj tjerë në situatë të ngjashme (pa formacionet e tyre territoriale dhe administrative). Për më tepër, deri në vitin 1932 nuk kishte pasaporta personale ose dokumente të ngjashme identifikuese ku identiteti nacional do të përmendej; pasaportat lëshoheshin vetëm për udhëtimet jashtë vendit, dhe nacionaliteti nuk përfshihej në to.

“UNIONI GJITHË-RUSË
I CIGANËVE”

Përfaqësuesit e ish elitës muzikore dhe artistike të romëve, e cila në të kaluarën kishte qenë ngushtë e lidhur me shoqërinë e lartë në ish Perandorinë Ruse, ishin të parët që u mblodhën nën pllakatet e ideologjisë së re “proletare”. Grupi i parë Comsomol i romëve (“Comsomol” është shkurtesë e shprehjes ruse për “Unionin e Rinisë Komuniste”) u krijua në Moskë në vitin 1923, në krye me Ivan Rom-Lebedev. Më pas ky grup u bë një shoqëri vullnetare, që filloi propagandën në mesin e romëve.

Krijimi i organizatave dhe shoqatave rome ishte nën kontrollin e

vazhdueshëm partiak dhe administrativ të Shtetit Sovjetik. Me ndihmën e Shtetit Sovjetik në vitin 1925 shoqëria vullnetare u bë “Unioni Gjithë-Rusë i Ciganëve”. Andrei Taranov, anëtar i Partisë gjithë-bashkuese Komuniste (Bolshevikët), u zgjedh Kryetar. Sekretari ishte Romi-Lebedev, i cili përfaqësonte romët në Departamentin e Nacionaliteteve në Komitetin Gjithë-bashkues Qendror Ekzekutiv. [III. 2]

Shpërbërja e “Unionit Gjithë-Rusë të Ciganëve” në vitin 1928 nuk pati ndonjë ndikim substancial në politikën shtetërore të udhëhequr në pajtim me qëllimet e përvijuara në statutet e saj, dhe për më tepër, u bë shumë më aktive dhe efektive. Shumica e anëtarëve të ish unionit, rreth 640 në përgjithësi, përfshirë shumicën e udhëheqësive, u tërhoqën në forma të ndryshme në realizimin e kësaj politike.

“KOLKOZET CIGANE”
(KOOPERATIVAT)

Në vitin 1926 Presidiumi i Komitetit Ekzekutiv Gjithë-Rus dhe Këshilli

të vendoseshin, do të pranoheshin kreditin, makinerinë bujqësore, bagëtinë, etj, por pastaj shpejt do t'i shinin të gjitha dhe do të shkonin në regjionet tjera.

“Kolkozet Cigane” u krijuan në regjionet e ndryshme të Republikave Socialiste Federative Ruse, Republikave Socialiste Sovjetike të Ukrainës dhe Bjellorusisë dhe në Azinë Qendrore Sovjetike. Shumica e tyre ishin shumë të varfra, nuk kishin bagëti të mjaftueshme e as makineri bujqësore, organizimi i tyre ishte i dobët, të mbjellat ishin të pakta, familjet e ndara vazhdimisht braktisnin kooperativën, etj, por kishte edhe disa përjashtime. “Kolkozet cigane” ishin relativisht të suksesshme në regjionin Smolensk (ku tendenca drejt vendosjes së romëve kishte ekzistuar para Revolucionit të Tetorit), në regjionet e stepave të Kaukazit verior (ku kishte shumë tokë të pazënë), dhe deri në një masë në regjionin Belgorod dhe në regjionin e Vollgës.

Në mesin e “Kolkozeve prijëse të Ciganëve” të përmendura në shtypin sovjetik të asaj periudhe ishin kooperativa “Tsiganskii trud” (puna “Cigane”) në Kaukazin verior, “Svoboda” (liria) në fshatin e Kardimovës, afër Smolensk, “Novaya Zhisn” (jeta e re) në regjionin Gorkii (Nizhnii Novgorod), “Novoe Shchastie” (lumturia e re) në regjionin Sarapul në regjionin e Sverdlovsk (Ekaterinburg), “Krasnyi put” (rruga e kuqe) në regjionin Sumy në Ukrainë, dhe “Lozovaya” në regjionin Kharkov të Ukrainës.

Është vështirë të përpilohet një listë e saktë e “kolkozeve Cigane”, pasi që pjesët e tyre shpejt do të shpërndaheshin, të tjerat do të transformoheshin, dhe të rejtat do të krijoheshin. Shpesh të ashtuquajturat “kolkozet e përziera” krijoheshin përmes bashkimit (administrativë) të njerëzve nga dy komunitetet e vogla brenda një regjioni. Shembuj ishin dy “kolkozet Cigane-Çifute” (në regjionin Vitebsk, Bjellorusi dhe regjionin Kirovgrad, Ukrainë), ose “kolkozet Cigane-Gjermane” (në afërsi të Eupatoria, Krimea), që ekzistonte për një kohë të shkurtë gjatë viteve të 1930-ta.

“Kolkozi Cigan” në Krikunovo “khutor” (lloji i vendosjes së fermerëve) shpesh përmendet në literaturë. Në fakt ky është “kolkozi i parë Cigan”, i krijuar para miratimit të dokumenteve normative përkatëse të lëshuara nga shtetit. 50 familje rome, të udhëhequra nga A.P.Krikunov, arritën në stepat e Kaukazit verior afër stacionit Dvoynaya, u vendosën në tokat e lira dhe themeluan kooperativën e tyre në pranverë të vitit 1925. Tri vjet pas themelimit të saj aty ishin 300 njerëz (70 familje) dhe kooperativa kishte 4,700 akër tokë, 40 kuaj (me sa duket të pamjaftueshëm për punimin e tokës), 1 dem, 20 lopë, 6 qe dhe 3 deve.

III. 3

i Komisarëve të Popullit të BRSS-së miratuan një dekret duke iu propozuar autoriteteve të republikave të unionit ndërmarrjen e hapave për masat prioritare për alokimin e tokave “Ciganëve” që dëshironin të vendoseshin, dhe dhënien e kushteve plotësuese favorizuese. Një dekret tjetër pasoi në vitin 1928, kur organet përkatëse ishin të obliguara të siguronin tokën për “Ciganët” që dëshironin të vendoseshin si një çështje prioritare, dhe secilës familje “Cigane” do t'i dhurohej nga 500 deri 1,000 rubla. U krijuan një komision për alokimin e tokës “Ciganëve” shëtitës, përfshirë gjithashtu përfaqësuesit e “Unionit Gjithë-Rus të Ciganëve”.

Masat u ndërmorën me qëllim të krijimit të “kolkozeve Cigane” (fermatve kooperative). Në fund të vitit 1927 diku rreth 500 familjeve rome në Ukrainë iu dhurova toka nga shteti dhe u krijuan 9 ferma kooperative. Në vitet 1931-32, periudha e kolektivizimit masiv, një vëmendje e posaçme iu kushtua lëvizjes së romëve, që dëshironin të vendoseshin në tokat e lira të stepave të Rusisë jugore. Menaxhmenti qendror i kooperativave krijoi “Departamentin e

punës me Romët” për 222 familje, që prisnin të vendoseshin në kooperativat rishtas të krijuara të “Ciganëve”. U lëshua një udhëzim “Për përmirësimin e punës së kolkozeve Cigane”, që kërkonte hapjen e çerdheve, qendrave mjekësore dhe shkollave në kuadër të kooperativave, dhe në të njëjtën kohë “për pastrimin e ‘kolkozeve Cigane’ nga elementet ‘kulak’ ” (pronarët e pasur; nuk kishte “kulaks” në mesin e romëve). [III. 3]

Propaganda sovjetike (përfshirë shtypin romë) paraqiste procesin e vendosjes dhe krijimit të “kolkozeve Cigane” si një proces vullnetar, që lindi në mënyrë të natyrshme në mesin e romëve shëtitës. Përkundër propagandës pompoze dhe me një ton qartësisht të rremë, kjo deri në një masë ishte e vërteta. Mirëpo, pavarësisht të gjithë përpjekjeve të Shtetit Sovjetik, rezultati ishte më shumë se modest. Në vitin 1932, 25 “kolkoze Cigane” u krijuan, përfshirë 490 familje, dhe në vitin 1938 ky numër u bë 52, përfshirë në mes 2-3% të tërë popullsisë rome në BRSS. Nëse autoritetet sovjetike kishin konsideruar seriozisht vendos-

jen e romëve shëtitës si një qëllim madhor, rezultatet vështirë se do të ishin aq modeste.

Dekreti i fundit shtetëror, që trajtonte “kolkozet Cigane” ishte ai i 4 prillit, 1936 mbi “Masat për punësimin e (Ciganëve) shëtitës dhe përmirësimin e standardeve ekonomike, kulturore dhe jetësore të punëtorëve Ciganë”. Sipas këtij dekreti, masat duhet të merreshin për përfshirjen pasuese të “Ciganëve” shëtitës në “Punëtoritë Zejtare të Kooperativës, “kolkoze”, “sovkoze” (fermat shtetërore), industri, si dhe për përmirësimin e kushteve jetësore në kalimin e tyre drejt mënyrës së vendosur të jetesës.

PUNËTORITË ZEJTARE TË KOOPERATIVËS CIGANE

Një linjë tjetër e realizimit të politikës shtetërore ndaj romëve ishte krijimi i “Punëtorive zejtare të Kooperativës Cigane” (“artelet”) në qytete. Mirëpo, në fillim krijimi i tyre kishte për qëllim jo vetëm përfshirjen e romëve që jetonin në qytetet, por edhe tërheqjen e një pjese të

"MËNYRA E RE E JETESËS" –
"ARTELET CIGANE"

Pas ndalimit të NEP "Punëtoritë Zejtare Cigane" vazhduan të zhvillohen, dhe gjithashtu u shfaqën forma të reja të prodhimit. Tri "artete të reja dhe të mëdha Cigane" u krijuan në Moskë në vitin 1927 – "Tsigchimprom" (industria kimike "Cigane"), "Tsigchilabor" (laboratori kimik "Cigan") dhe "Tsigpishcheprom" (industria e ushqimit "Cigan"). Emrat e mëdhenj nuk duhet të jenë çorientues – në fakt këto ishin kooperativa të vogla, që prodhonin lloje të ndryshme të ngjyrës, detergjenteve kimike dhe ambalazheve për produkte të ushqimit. Vetëm në Moskë në vitin 1931 ishin 28 "artela Cigane" me 1,351 anëtarë (dhe me familjet e tyre 3,755 njerëz) – "Transporti i Ushtrisë" (një ndërmarrje shtetërore për prodhimin e kushinetave), "I huaji rumun", "Rumuni i parë Serb", "Transbaikaliani i kuq", "Rumuni Grek", "Rumuni Serb", "Stalin", "Mënyra e re e jetesës", "Emigranti i detit

të zi", "II Romuni Serb", "Ndërkombëtar", "Teneqexhiu nga Tifliski", etj. Emrat e shpeshtë rumun, serb, grek tregojnë se këta romë (kryesisht Kalderash) kishin ardhur nga këto vende në të kaluarën dhe shpesh kishin mbajtur pasaportat e huaj.

"Arteli më i madh Cigan" ishte "Natsmenbit" (mënyra e jetesës të minoriteteve nacionale) në Leningrad i krijuar në vitin 1934 ku rreth 200 njerëz punonin, prodhonin bojlerë të bakrit, fuçi të hekurt dhe artikuj të tjerë të metalit. Mirëpo shumica e "arteleve" ishin më të vogla dhe ishin krijuar në pajtim me vendosjen e romëve shëtitës. Kështu që në dhjetor 1936, 12 familje të Kalderashit dëshironin të qëndronin në qytetin e Yoshkar-Ola, kryeqytetin e Mari të RSS Autonome dhe krijuan "artelin" e tyre për prodhimin e pajisjeve shtëpiake të metalit. Arteli "Flaka e revolucionit"- në Stalingrad ngjashëm u krijua në vitin 1936; komiteti ekzekutiv lokal miratoi 464 rubla ndihmë dhe hua për organizimin e prodhimit dhe përmirësimin e kushteve jetësore.

III. 4

PUBLIKIMET ROMANI PREJ 1927 DERI 1938

Gazeta "Romani Zorya" (agimi romë) filloi të dal në vitin 1927. Prej vitit 1930 deri në 1932 u zëvendësua nga "Nevo Drom" (rruga e re). Gazeta "Butyaritko Roma" (romët punëtorë) u botua njëherë në vitin 1932. Gazetat, kryesisht në gjuhën Romani, botonin material të ndryshëm, përfshirë folklorin romë dhe punimet letrare. Sasia e literaturës së botuar në Romani është mbresëlënëse. Literatura e botuar ndahej në disa kategori kryesore: shoqërore dhe politike, Marksiste -Leniniste; për çështjet e "kolkozeve"; teknike

dhe prodhuese; shkenca popullore; letërsi të trilluar (nga autorë romë dhe përkthimet në Romani). Në mes të viteve 1931 dhe 1938, 292 tituj të ndryshëm u botuan në Romani. Shumë nga këto botime mbanin karakterin e propagandës ruse të asaj periudhe, duke vlerësuar nga titujt e tyre që janë mjaft shprehës, për shembull: "Lenini është flamuri ynë", "Ciganët e rinj po vijnë", "Punëtore femra, mos besoni në zot", "Çka i dha pushteti sovjetik femrave Cigane" etj. Shumë libra u botuan, që kishin për qëllim njohjen e

romëve shëtitës drejt jetës së vendosur. "Artelet" e para rome u krijuan disa vjet para se shteti të fillonte politikën e përkrahjes së tyre. Një "Tsiganskaya artele" – "Punëtori zejtare e Kooperativës Cigane" – veçse ekzistonte në vitin 1923 në Moskë, kryesisht me anëtarësi të romëve Kalderash; "Artelet Cigane" për punimin e bakrit u regjistruan edhe në Khar'kov dhe Leningrad. Legjislacioni fundit shtetëror, që trajtonte "artetelet Cigane" ishte dekreti i vitit 1936, sipas të cilit "Vsesojuspromsovet" (Këshilli Gjithëbashkues Industrial) duhet të ndërmernte masa speciale për përkrahjen dhe zgjerimin e "arteleve Cigane" dhe bazën e tyre të prodhimit; të organizonte përgatitjen dhe trajnimin e anëtarëve të tyre; të përmirësonte kushtet jetësore, të zgjeronte aktivitetet kulturore dhe arsimore në mes të romëve që punonin në "artetele". [III. 4]

GJUHA DHE
LITERATURA ROME

Linja e dytë kryesore e një realizimi aktiv të politikës shtetërore ndaj romëve ishte zhvillimi i Romani, gjuhës së romëve, dhe literaturës Romani.

Përpjekje serioze filluan pas publikimit të një artikulli në gazetën "Izvestia" "Mbi shembujt e letrave Cigane", që është në versionin e alfabetit Romani dhe gjuhës së saj letrare, bazuar në dialektin e romëve rus, të krijuar nga aktivistët e njohur romë Nikolai Pankov dhe Nina Dudarova. Dekreti "mbi krijimin e alfabetit romë" u lëshua me 10 maj, 1927, nga Anatolii Lunacharskii, kryetar i "Narkompros" (Komisariati Popullor për Arsim) dhe një mbledhje u mbajt me përfaqësuesit e Departamentit Kryesor të Shkencave, Këshillit për Mi-

noritete Nacionale dhe Unionit Gjithërus të Ciganëve. Një vendim u mor për krijimin e alfabetit Romani (bazuar në alfabetin rus) dhe u zgjodh një komision për përgatitjen e draftit për gjuhën standarde rome, përfshirë profesorin Mikhail Sergeevskii, nga Universiteti Shtetëror i Moskës, Nikolai Pankov, dhe Nina Dudarova.

Studimi i Sergeevskiiit "Mbi gjuhën e Ciganëve rus" u publikua në vitin 1929 dhe gramatika e tij Romani u paraqit në vitin 1931, fjalori Romani-Rusisht, i përpiluar nga Mikhail Sergeevskii dhe Alexei Barannikov, redaktuar nga Nikolai Pankov, në vitin 1938.

Një sasi e konsiderueshme e literaturës së botuar në gjuhën Romani deri në vitin 1938 padyshim se pati ndikim në zhvillimin e komunitetit "Cigan". Sidoqoftë, ky ndikim ishte vetëm në një rreth relativisht të kufizuar, kryesisht



III. 5
Botimi i parë i gazetës “Romani Zorya” (Agimi i romëve), Moskë, 1927
(nga Djurić, Rajko et al. (1996) Ohne Heim - ohne Grab. Die Geschichte der Sinti und Roma. Berlin: Aufbau Verlag, p. 184b)

III. 6
Faqja nga gazeta Romani “Nevo Drom” (Rruga e re), 1931, nos. 4-5). Gazeta publikoi disa artikuj posaçërisht për romët, por shumë faqe u shkurtuan nga përkthimet e propagandës së përgjithshme nga rusishtja në Xaladytka Romani. Kjo faqe tregon për “zakonet e lashta” që shtypin femrat: titulli më lart lexon, “Femrat në lindje”, dhe kjo më poshtë lexon “vajza-punëtore Romani, shkruaj për jetën tënde të re.” Dhënë nga Biblioteka Lenin.
(nga Lemon 2000, f. 135)



romëve me bujqësinë dhe kooperativat, organizimin e uzinave dhe zeje të ndryshme. Një numër i madh i botimeve iu kushtuan problemeve praktike të jetës familjare, siç ishte “Ndihma e parë në situata emergjente”, “Çka të bëni kur fëmija juaj ka diarre”, “Higjiena për femra”, etj. Botimet tjera janë të një natyre të njohurisë së përgjithshme, dhe disa vështirë se do tërhiqnin interesimin e romëve si lexues të ardhshëm, për shembull, “Për mamutët”, “Për majmunët”, “Gërmimi i mineraleve dhe xeheve”. Përkth-

imet e trillimeve përmbajnë një numër të përkthimeve të punimeve klasike në gjuhën Romani, për shembull punimet e Aleksandër Pushkin (novelat, tregimet dhe poezinë “Ciganët”), Lev Tolstoy, Maksim Gorki (përfshirë tregimin “Makar Chudra”), Michail Sholokhov. Dyzet e shtatë punime nga autorët romë (vjersha dhe prozë), Maksim Besljudsko, Aleksander German, Ivan Rom-Lebedev, Nikolai Pankov etj. gjithashtu u botuan.

III. 7

në Moskë dhe në disa qytete në BRSS. [III. 5-7]

ARSIMI

Ky aktivitet intensiv i botimeve në një masë të madhe ndërli dhej me politikën shtetërore në fushën e arsimit. Gazeta “Izvestia” e datës 8 qershor, 1925, publikoi një artikull, duke cituar “Ciganët” në mesin e popujve, me të drejtë të arsimit të tyre. “Një abetare për Shkollat Cigane”, e publikuar në vitin 1929 nga Nina Dudarova, si dhe “Një abetare për njerëzit gjysmë-analfabet”, e përpiluar nga Nikolai Pankov, ishin në mesin e edicioneve të para për romët e këtij lloji në botë. Deri në vitin 1938 u publikuan gjithsej 13 libra mësimore në gjuhën Romani, ku e fundit ishte “Lylvari Piro Romany Chhib” (një libër mësimor në

Romani) nga A. V. Germano, si dhe librat dhe materialet tjera mësimore.

Puna aktive për ngritjen e shkrim leximit dhe nivelit arsimor për romët e rritur përmes të ashtuquajturve kurse “likbez” (zhdukje e analfabetizmit), mësimet të natës etj. filluan gjatë gjysmës së dytë të viteve 1920-ta. Shkollat rome dhe çerdhet, të cilat zyrtarisht nuk ishin institucione të ndara arsimore, filluan të ekzistojnë si pjesë të institucioneve tjera.

Numri i shkollave ekzistuese rome ndryshonte kohë pas kohe, pasi që të rejtat vazhdimisht hapeshin (për shembull në “kolkozet Cigane”), ndërsa në të njëjtën kohë të tjerat shpërbëheshin ose mbylleshin (për shkak të kushteve të këqija, mungesës së mësuesve të trajnuar, ose mosinteresimit të fëmijëve romë). Në përgjithësi, gjatë periudhës 1926-1938, 86 shkolla rome

ekzistonin për gjatësi të ndryshme kohore ose klasat me një status të tillë. Në vitin 1938, ekzistonte një shkollë bazike (deri në klasën e 7-të) dhe 25 shkolla fillore (deri në klasën e 4-të), si dhe një shkollë rome me konvikt (në Serebryanka, te Smolensk) ku grupet rome merrnin pjesë në dy shkolla me konvikte dhe katër çerdhe.

Librat dhe materialet mësimore të shkruara në dialektin e romëve rus u përdorën në shkollat rome. Mirëpo, në disa raste për romët nga grupet tjera ishte një dialekt i vështirë, prandaj kishte tentime për adaptimin e mësimimit të gjuhës Romani, duke zgjedhur një dialekt tjetër.

Me 21 dhjetor, 1931, Komiteti qendror i Partisë Komuniste Gjithë-Ruse (Bolshevikët) hapi një shkollë speciale për “Partinë Cigane”, ku të diplomuarit e parë ishin 18 meshkuj dhe 2

TRAJNIMI I MËSUESVE ROMË

Arsimimi i përgjithshëm në shkollat dhe mësimet rome u planifikua të bëhet në Romani, që shkaktoi një problem akut për mësuesit e trajnuar. Kurset arsimore të romë ve u krijuan në vitin 1927 ku Nina Dudarova dhe Nikolai Pankov i mësuan dhe trajnuan mësuesit e parë romë. Kurset pedagogjike të romëve filluan në Moskë në vitin 1931, ku kursi i parë regjistroi 30 studentë nga 80 pas konkursit. Këto kurse vepronin paralelisht me kurset intensive verore në Toropets (regjioni Kalinin), Nevel (regjioni Pskov), Serebryanka (afër Smolensk), në Kharkov, Ivanovo, Saratov, Sverdlovsk, Leningrad, Orel dhe gjetiu. Kurset pedagogjike rome në Moskë u riorganizuan në kolegje pedagogjike me një sektor romë në vitin 1932, ku deri në vitin 1938, në mes të 120-140 studentë romë diplomuan. Të diplomuarit braktisën vendin, ku duhet të punonin në shkollat rome. Sidoqoftë, shpesh këta mësues preferonin të caktoheshin në shkollat “normale” – të përziera -, në vend të krijimit të shkollave të reja rome.

III. 8



III. 9

Mbledhja e “Russka intelligentsia” me Anatolii Lunacharskii në vitin 1930 për krijimin e “Teatrit Romani të Moskës”. Pas mbledhjes me Anatolii Lunacharskii me 4 tetor, 1930, në një mbledhje të aktivistëve të arteve nacionale të “Narkompros” u morë një vendim për themelimin e një Studio për “Teatrin Indo-Romen”, dhe me 24 janar, 1931, u hap teatri.

(nga Lemon 2000, f. 131)

“TEATRI ROMEN”:

PROMOVIMI I VLERA VE TË “JETËS SË RE”

Ideja për një teatër romë u parashtrua nga një grup i aktivistëve të “Unionit të shpërbërë Gjithë-Rus të Ciganëve”, të bashkuar në klubin “Cigan” “Loly Cheren” (Ylli i kuq). Per-

formansa e parë ishte në maj të vitit 1931 – një performansë në dy pjesë, një skeç propagandues “Atasya i dadyves” (“Dje dhe sot”) dhe një “skeç etnografik”. Sidoqoftë, premiera e parë e vërtetë ishte me 16 dhjetor të të njëjtit vit, kur u performua “Jeta në rrotë” nga Aleksander Germano, duke i dhënë emrin teatrit “Romen”. Në vitet e 30-ta “Teatri Romeni” sh-

femra. Kohëzgjatja e shkollës ishte 10 muaj, ata të cilët diplomuan u dërguan të punonin si organizatorë dhe të merrnin përgjegjësitë e funksionarëve në aktivitetet propaganduese në shkollat e “kolkozeve Cigane”, dhe madje në kampet nomade të romëve. [III. 8]

“TEATRI ROMEN”

Krijimi i “Teatrit Cigan Romeni” përgjatë viteve 1920-ta dhe 1930-ta ishte veçanërisht i rëndësishëm në politikën shtetërore ndaj “Ciganëve”, që me kohë fitoi një domethënie simbolike. Teatri ishte përfundimi i procesit të inkorporimit të elitës muzikore rome (kryesisht të përqendruar në Moskë dhe Leningrad) në realitetin e ri sovjetik. Fillimisht ishte

e vështirë për elitën të gjente vendin e saj në shoqërinë e re sovjetike. Kështu që romët iu bashkëngjiten strukturave të reja sovjetike duke ofruar fonde për organizimet muzikore. Prandaj “Kori i Ciganëve” i Nikolai Kruchinin, u regjistrua në vitin 1920 në Departamentin Muzikor “Narkompros” me emrin “Studio për artin e vjetër Cigan”.

“Teatri Romeni” nuk ishte vetëm një mundësi për realizimin e elitës muzikore rome (e cila në fakt po ndryshonte në atë periudhë, duke filluar të përfshinte përfaqësuesit e grupeve tjera të ndryshme të romëve rus). Në shumë qytete të mëdha në BRSS u krijuan ansamble të ndryshme muzikore përmes ndihmës shtetërore, në kuadër të institucioneve të ndryshme kulturore sovjetike ose në kuadër të qendrave kulturore lokale. Për shembull, në

vitin 1932 në Moskë, ekzistonte “Studio Teatrale Shtetërore e Ciganëve” dhe “Teatri i Ciganëve Udhëtues”. [III. 9, 10]

SHTYPJET E VITEVE
TË 1930-TA

Politika staliniste e shtypjeve masive filloi në vitet e 1930-ta. Shumë romë ishin viktimë e këtyre shtypjeve. Mirëpo, ata nuk niseshin nga bazat racore ose nacionale, por ishin në pajtim me ideologjinë e përgjithshme zyrtare sovjetike të kësaj periudhe. Në këtë rast romët trajtoheshin mesatarisht si të gjithë qytetarët sovjetik.

Vala e parë e shtypjeve ishte në vitet 1932-1933, pas futjes së kartelave identifikuese dhe regjistrimit të obligueshëm sipas vendbanimit (të kombinuara

VIKTIMAT ROMË TË PUSHKATIMEVE MASIVE III. 11

Romët u dëbuan pa ndonjë dënim. Në Siberi ata në përgjithësi nuk u vendosën në kampe, por u dëbuan në vende të ndara dhe ishin nën administrim relativisht të lehtë. Në të njëjtë kohë rreth 3 deri 5 milion fshatarë (vlerësimet dallojnë), “kulaks” të deklaruar, u dëbuan gjatë kolektivizimit të zbatuar, së bashku me familjet e tyre. Ndryshe nga fshatarët, romët nuk qëndruan në vendbanimet e tyre të reja. Gjatë disa viteve, duke tejkaluar shumë

vështirësi dhe vuajtur ata arritën të braktisnin vendet ku ishin dëbuar dhe ringjallën mënyrën e mëparshme të jetesës, kryesisht në pjesën evropiane të BRSS-së. Me sa duket autoritetet nuk i merrnin ata seriozisht dhe në shumë raste ishin mospërfillës kur romët braktisnin vendet në të cilat ishin dërguar. Fakti se romët iu kthyen mënyrës shëtitëse të jetesës ose shpesh braktisnin vendbanimet e tyre, nuk shihej si një problem i veçantë nga autoritetet, përderisa romët nuk i afroreshin qyteteve të mëdha dhe qëndronin në periferi të regjioneve rurale.

DËBIMET MASIVE TË ROMËVE III. 12

Fillimisht, në vitet e 1930-ta romët u dënuan me burgim në kampe, por në vitin 1937 filloi “spastrimi” masiv i kampave nga “elementet anti-Sovjetike”, me kuotat e numrit të burgosurve në kampe që duhet të pushkatoheshin, sipas akuzave plotësuese. Romët gjithashtu ishin në mesin e viktimeve të pushkatimeve masive në kampe. Kështu që në kampin Solovki, në Karelia gjithsej 13 Kalderash nga dy familje të mëdha (Stanesco dhe Mihai) u pushkatuan në vitin 1937. Këto ekzekutime masive u kryen në lokalitetin Sandomorkh, ku gjithsej mbi 9,000 njerëz u vranë gjatë periudhës 1937-1938. Përveç 13 Kalderashëve edhe romë të

tjerë u pushkatuan në Sandomorkh, 27 prej tyre nga romët rusë, të cilët më herët kishin punuar në ndërtimin e kanalit Belomor-Baltic (kryer nga puna e dhunshme në kampet e përqendrimit).

Numri i përgjithshëm i romëve, të cilët vdiqën gjatë fushatës 1937-1938, sipas hulumtimit të Shoqatës Përkujtimore, ishte 52 të pushkatuar në Sandomorkh, Smolensk, Kursk, Marii-El, dhe gjetiu. Natyrisht të dhënat nuk janë të plota, dhe me gjasë numri i përgjithshëm është shumë më i madh. Spastrimet masive gati nuk patën ndikim në “elitën” e re sovjetike të romëve, ndryshe nga popujt tjerë në BRSS, ku gati e tërë inteligjenca dhe aktivistët partiak u vranë në periudhën e shtypjeve masive.

pejt gjeti veten në jetën muzikore dhe kulturore të BRSS-së dhe u bë shumë i famshëm në mesin e shoqërisë rome dhe sovjetike në përgjithësi. Repertori i tij në mënyrë të pashmangshme përfshinte interpretimet me karakter propagandues, duke promovuar vlerat e “jetës së re” në mesin e romëve (shumica të shkruara nga autorët aktivistë romë). Kur “Teatri Etnografik”

në Leningrad shfaqti dy interpretime në vitin 1932, “Romano Drom” (Rruga rome) dhe “Gilya i Khelibena Romen” (këngë dhe vallëzime “Cigane”) redaktuar nga regjisori V.N. Vsevolodskii-Gerngross, kishte kritika serioze në shtypin romë, që ato nuk arritën të tregojnë kalimin nga mënyra udhëtuese e jetës në jetën në “Kolkozet Cigane”.

III. 10

me dhënie e librave ushqimor) me 27 dhjetor, 1932. Moska, Leningradi, Kievi, Odessa, Minsku, Kharkova, dhe të tjerat ishin në kategorinë e “qyteteve të mbyllura”, ku regjistrimi ishte më i vështirë, dhe mundësitë e fitimit të jetesës shumë më të mëdha. Shumë njerëz do të vinin në këto qytete, përfshirë romët udhëtues; autoritetet reagon me anë të bastisjeve për zënie e “elementeve jo klasore”, të cilët ishin dëbuar (kryesisht në Siberi) pa ndonjë dëgjim gjyqësor apo dënim. Dëshmitë e dëbimeve masive të romëve vinin kryesisht nga Moska dhe qytetet tjera të mëdha në BRSS. [III. 11]

Vala e dytë e shtypjeve, që gjithashtu përfshinte romët, ishte në vitet 1936-1937, kur më nuk ishte çështje e dëbimeve, por e “dënimeve gjyqësore”. Në fakt, kjo vështirësi që është emri më

i përshtatshëm për vendimet e të ashtuquajturës “troika” (tribunalet NKVD). Romët gjithashtu ishin viktime të shtypjeve, akuzat kundër tyre në përgjithësi kishin të bënin me disa çështje. Më së shpeshti arsytet për dënim ishin “spekulimi me valutë”. Vjedhja e kuajve u shndërrua nga një vepër penale në krim politik dhe “sabotim” ndaj shtetit socialist. Një akuzë tjetër e shpeshtë kundër romëve ishte akuzat e spiunimit në dobi të ndonjë vendi të huaj, zakonisht me arsyetimin e pranisë së pasaportave të huaja në mesin e shumë romëve, të cilët ishin vendosur kohëve të fundit në qytete (më së shpeshti Kalderashët), disa nga të cilët ishin të pafat në regjistrimin e “artelevëve të tyre” me emra të huaj. Shpallja e romëve si spiunë të huaj ishte absurde, natyrisht, por nuk ishte e pazakonshme

në Bashkimin Sovjetik të asaj kohe, në sfondin e zbulimit të “spiunëve të huaj”, madje edhe në mesin e skalioneve më të larta të nomenklaturës partiake. [III. 12]

NJË KTHESË NË POLITIKËN NACIONALE

Një ndryshim rrënjësor në politikën shtetërore ndaj romëve u paraqit në vitin 1938. Një “shënim” i Komitetit qendror të Partisë Gjithë-Ruse Komuniste (Bolshevikët) dha udhëzimet për mbylljen e 18 klasave nacionale në sistemin arsimor si dhe shkollave ekzistuese të 16 nacionaliteteve të ndara. Lista përfshinte njerëzit pa formacione shtetërore-administrative (apo që jetonin përtej tyre) – për shembull Armenët (që jetonin

përtej Republikës Socialiste Sovjetike të Armenisë), Polakët, Gjermanët etj. duke mbaruar me Kurdët, Asirianët dhe Romët.

Ndryshimet nuk patën ndikim vetëm në fushën e arsimit. Publikimet masive të librave në gjuhën Romani u ndërpre, performansat e “Teatrit Roman” filluan të bëhen në gjuhën ruse (me pjesë të ndara dhe këngë në gjuhën Romani). Gradualisht “artelet Cigane” dhe “kolkozet” filluan të shkatërrohen. Procesi ishte i ngadalshëm, dhe një pjesë e romëve prapë filluan mënyrën nomade të jetesës.

Në gjysmën e dytë të viteve të 1930-ta e ashtuquajtura politika nacionale “Leniniste” ia liroi rrugën politikës nacionale “Staliniste”. Ndryshimi filloi

me kushtetutën e re të BRSS-së, të miratuar në Kongresin e 8-të të Sovjetikeve në nëntor 1936. Kishte pretendime se kjo kushtetutë ua mohonte romëve statusin e tyre si “minoritet nacional”, mirëpo, pretendimi nuk kishte substancë. Askund në kushtetutën e re ose në dokumentet tjera shtetërore nuk ka ndonjë listë të popujve me (ose pa) një “status të minoritetit nacional”, e as nuk përmenden romët në veçanti. Romët ishin një çështje e vogël në kontekstin e politikës së përgjithshme nacionale të shtetit, dhe nuk ishte rastësi që në listën e popujve, shkollat nacionale të cilëve duhet të mbylleshin, shkollat rome ishin në fund të listës.

Masat e politikës së re nacionale sovjetike u zbatuan në linja të

ndryshme dhe kishin për qëllim heqjen e dallimeve etnike në BRSS. Qëllimi i përgjithshëm ishte të arrihej një fazë e re e zhvillimit nacional – koncepti i “popullit sovjetik”. Kjo ishte shprehja kryesore në politikën nacionale në BRSS dhe në fakt ishte një zhvillim i idesë së vjetër imperiale të “Rusisë dhe ‘Rossiane’” (që do të thotë popujt që i përkisnin Rusisë, dhe jo “Russkie” – Rusët etnik). Politikat konkrete shtetërore iu ishin nënshtuar kësaj paradigme themelore, për shembull, formacionet shtetërore dhe administrative, të cilat për qëllime praktike “krijuan” një numër të popujve të rinj bazuar në klanet e hershme dhe formacionet fisnore. Politika shtetërore lidhur me romët zbatoi këtë paradigmë.

PËRFUNDIM

Ekzistojnë kthesa të konsiderueshme dhe madje (së paku në dukje) disa kundërtënie në politikën e shtetit sovjetik lidhur me romët. Deri në vitin 1938 politika ndaj romëve ishte e bazuar në trajtimin e tyre si popull i ndarë, të cilët mbi të gjitha duhet të zhvillohen si një komunitet etnik, që është pjesë e shoqërisë sovjetike, duke krijuar “kolkoze të ndara Cigane”,

“artelet Cigane”, shkollat “Cigane” etj. Pas vitit 1938, paradigma ndryshoi, elementi “special” në politikë ia liroi rrugën “qasjes mbizotëruese, të përgjithshme” dhe romët shiheshin mbi të gjitha si një pjesë integrale e shoqërisë sovjetike, pa ndonjë ndarje speciale në fushat kryesore shoqërore (ekonomi, arsim, etj.); si komunitet, zhvillimi i tyre u mbështet në kornizën e një plani etno-kulturor (mbi të gjitha në fushën e muzikës dhe vallëzimit).

Rezultati i qasjes së parë përfshinë një rreth shumë të kufizuar të elitës së re rome sovjetike. Përmes qasjes së dytë, edhe pse nuk mund të flasim për një politikë të plotë dhe pasuese të shtetit për zhvillimin e komunitetit romë, një numër i mundësive u krijuan, të cilat garantuan një pjesëmarrje të barabartë të romëve në jetën publike dhe përmirësim të kualifikimit të tyre arsimor dhe vetëdijes së tyre qytetare.

Bibliografia

Barannikov, Aleksei P. (1931) *Tsygany SSSR. Kratkii istoriko-etnograficheskii ocherk. Moskva* | **Bessonov, N. / Demeter, N. G. / Kutenkov, V. (2000)** *Istoriya tsygan. Novyi vsglyad. Voronezh: Rossiyskaya Akademyiya Nauk* | **Crowe, David (1995)** *A History of the Gypsies of Eastern Europe and Russia. London / New York: I. B. Tauris Publishers* | **Fraser, Angus (1992)** *The Gypsies. Oxford / Cambridge: Blackwell* | **Kalinin, Valdemar (2003)** *Zagadki baltiiskikh tsygan (Rossiya, Estoniya, Litva, Latvija, Polsha). Vitebsk* | **Kenrick, Donald / Taylor, Gillian (1998)** *Historical Dictionary of the Gypsies (Romanies). Lanham, Md.: The Scarecrow Press* | **Lemon, Alaina (2000)** *Between two Fires. Gypsy Performance and Romani Memory from Pushkin to Post-Socialism. Durham / London: Duke University Press* | **Marushiakova, Elena / Popov, Veselin (2003)** *Social Position of the Gypsies in Contemporary Russia and the Countries of the former USSR (Historical Background and Contemporary situation). In: Dvorák, Tomáš (ed.) Mily Bore ... Profesoru Ctiboru Necasovi k jeho sedmdesátým narozeninám venuj i prátelé, kolegové a záci. Brno: Historický ústav AV CR, pp. 237-244*

